



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 21.03.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 42 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 nën paragrafi 2.3 të nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me datë 24.02.2025 publikon këtë:

ZGJATJEN E AFATIT PËR APLIKIM

Për pranimin e aplikimeve për Anëtarë të Komisionit të Pranimit (Profesor të fushës së njëjte për procedurën të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit.

1. Aplikantët për anëtarë të Komisionit të Pranimit (Profesorë të fushës së njëjte për procedurën të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit, në pajtim me dispozitat e nënparagrafit 2.3 paragrafit 2 të nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
2. **Profesor në fushën: e inxhinierisë, fushat Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinier Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknikë.**

Aplikantët për anëtarë të Komisionit të Pranimit (profesorë të fushës së njëjte për procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

I përzgjedhuri për anëtarë të Komisionit të Pranimit (profesorë i fushës së njëjte për procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimit për kategorinë e specialistit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 21 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikës 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e specialistit, është i hapur nga data **21/03/2025** deri më datë **26/03/2025**.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për anëtarë të Komisionit të Pranimit (profesorë të fushës së njëjte për procedurën për të cilën zhvillohet konkurrimi) për kategorinë e specialistit, dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: Mapl.Dbnj@rks-gov.net për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 64 105.

Ju faleminderit!